

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues e përbërë nga gjyqtarja Raima Elezi si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarëve Vjollca Buzhala dhe Teuta Krusha, anëtarë të trupit, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. H. nga fshati .., për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.47/14 të datës 18.06.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit i Prokurorisë Themelore, Departamenti për Krime të Rënda në Prizren Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B. N. nga Prizreni, me datën 07.04.2017 morri dhe shpalli këtë

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. H., nga i ati H. dhe e ëma F. i lindur K., i lindur më datën ... në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, ku edhe banon, rojtar pylli, i suspenduar, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar babë 5 fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, ka qenë në paraburgim prej 20.02.2014 deri më datën 14.03.2014.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK

LIROHET NGA AKUZA

Se në periodën kohore prej shtatorit të vitit 2013 gjerë më 20.02.2014 në lokacionin e Parkut Nacional tek fshati M., Komuna e Prizreni, në cilësinë e personit zyrtar kujdestar në Parkun Nacional “Sharri” me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, dhe për personat të tjerë mundëson përvetësimin e pasurisë e cila iu është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij, në atë mënyrë që në lokacionin e parkut nacional tek fshati M., në regjionin të cilën e mbulon i akuzuari sipas detyrës së tij kujdestar të parkut ka lejuar prerje të mëdha të drurëve e cila ka rezultuar me një humbje në vlerë 170m³ (njëqind e shtatëdhjetë metra kub) drurë të prerë në vlerë rrethe 53.074 (pesëdhjetë e tre mijë) € i cili dëme është vlerësuar në bazë të komisionit të formuar të parkut nacional “Sharri” në Prizren.

-kësodore do të kishte kryer veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 të KP-së,

- pasi që vepra për të cilën i akuzuari akuzohet, nuk është vepër penale.

I dëmtuari Parku Nacional “Sharri” për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.nr.47/14 të datës 18.06.2014, kundër të akuzuarit F. H. nga ... Komuna e Prizreni, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 të KP-së. Në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës duke theksuar se me provat e administruara edhe atë me dëgjimin e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të Parkut Nacional “Sharri, drejtori H. D., anëtarëve të komisionit të cilit kanë bërë vlerësimin e dëmit të shkaktuar në parkun nacional “Sharri”, dëshmitarëve R. D., E. K. si dhe R. K. dhe nga fotodokumentacioni e cila është shtjelluar edhe më një video incizim mbi prerjet ilegale që janë bërë në Parkun Nacional “Sharri”, në regjionin e M. në periudhën kohore 2013 dhe shkurt të vitit 2014 me pamëdyshje është provuar dhe vërtetuar gjendja faktike se këtu i akuzuari F. H. në cilësinë e personit zyrtar – rojës në Parkun Nacional regjioni i M., me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vetë dhe tjerët mundëson përvetësimin e pasurisë e cila i është besuar sipas detyrës apo pozitës së tij, në atë mënyrë që në lokacionin e parkut nacional të fshatit M. regjion të cilin e mbulon me vendim të parkut nacional roja, gjegjësisht kujdestar i parkut, ka lejuar prerje të mëdha të druve e cila sipas vlerësimit të komisionit të parkut nacional “Sharri” në një humbje prej 170m³ në vlerë të druve të prerë që arrin shumën prej 53.074€, andaj nga gjithë kjo konsideron se në tërësi është provuar me provat dhe faktet se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 të KP-së. Propozon që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënon sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-së, shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale, pasi kemi të bëjmë me shkrëtimin e parkut i cili është e mbrojtur me ligje të veçanta dhe krejt atë shkrëtim e ka mundësuar i akuzuari F. H., po ashtu edhe vlerat të cilat duhet të mbrohen të cilat në rastin konkret janë dëmtuar në mënyrë të pa riparueshme duke shkrëtuar Parkun Nacional “Sharri” regjioni i M., andaj kërkon që dënimin të jetë adekuat dhe në proporcion me peshën e veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. B. N. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se edhe pse kërkesa për hedhjen e aktakuzës nuk është pranuar, e njëjta megjithatë përmban kontradikta të theksuara në përshkrimin faktik në krahasim me cilësimin juridik por edhe me gjendjen faktike e cila pretendohet të bazohet në prova të propozuara me aktakuzë dhe të administruara gjatë seancave hetimore pranë këtij trupi gjykues. Një shikim sipërfaqësor i përshkrimit faktik dhe krahasimi i këtij përshkrimi me përcaktimin ligjor tregon se ekziston disharmoni sa i përket veprimeve të pretenduar në anën e atë akuzuarit sipas aktakuzës dhe atyre të kërkuara sipas dispozitave ligjore si edhe sa i përket objektit të pretenduar sipas aktakuzës dhe të mbrojtur sipas dispozitave ligjore duke përfshirë edhe pretendimin e sasisë dhe vlerës ku sipas provave që janë administruar e që kanë të bëjnë me sasinë e konfiskuar dhe dorëzuar Agjencisë për mbrojtje për administrim të pasurisë së konfiskuar ku, nëse krahasohet edhe me deklaratat e dëshmitarëve prezent sidomos të policisë dhe realizimit në të holla, dukshëm nuk përputhet me pretendimin e aktakuzës dhe nuk ka të bëjë me veprimet e të akuzuarit F. H. Me aktakuzën pretendohet se i mbrojturi i tij sipas vendimit të Parkut Nacional ka qenë i caktuar për rajonin ku pretendohet se është bërë dëmi – prerja e sasisë

drunore. Ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse me kontratë dhe me vendim nuk është i caktuar terreni konkret e sidomos ai i cili është pretenduar nga përfaqësuesi i akuzës. Vendimi ka të bëjë vetëm me përcaktimin e funksionit të kujdestarit të Parkut Nacional - malet e "Sharrit", me gjithë atë gjatë administrimit të provave, dëgjimit të dëshmitarëve pikërisht dëshmitarit L. H. pamëdyshje është konstatuar se për atë teren është kujdestar ai dhe se i akuzuari gjithmonë në çdo mbledhje ka theksuar se ai në atë teren nuk mund të shkon nga se është i rrezikuar mu nga ky dëshmitarë. Sa i përket elementeve të veprës penale ka shtuar se dispozita ligjore parasheh përvetësimin e pasurisë, pra një veprim që ka të bëjë me një aktivitet të realizuar në kuptim të marrjes së një pasurie për vete apo të mundësimit të marrjes së këtillë për një person tjetër, në rastin konkret edhe pse nuk ka të bëjë me të akuzuarin F. një veprim i këtillë nuk ekziston, pra një element i domosdoshëm i paraparë me dispozitat ligjore mungon andaj nuk plotësohen pretendimet e veprimit antiligjor. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka mund të bënte një vepër i cila i vihet në barë andaj propozon që i njëjti të shpallet i pafajshëm dhe të lirohet nga akuza.

I akuzuari F. H. duke mohuar kryerjen e veprës penale në mbrojtjen e vetë ka theksuar se prej datës 03.08.2009 punon si roje në Parkun Nacional "Sharri", në regjionin e M. i cili terren gjendet ndërmjet Struzhës dhe Manastiricës, vazhdon me liqenin ku ndodhet varri i "Meto Bajraktarit" dhe te poshtë në Lubinje të Poshtme deri në Lubinjen e Epërme. Sipas kontratës punon prej 08:00 deri në ora 16:00, të shtunën dhe të dielën nuk punon. Është e vërtet se pjesën e epërme që quhet "Zamka" nuk ka vizituar edhe pse ajo pjesë është në fushë veprimin të tij dhe ka obligim të kontrolloj, por për shkak të sigurisë dhe kërcënimeve nga kolegu L. H. nuk ka shkuar, një herë ka qenë i kërcënuar nga ai sepse ka vizituar një teren për të cilin ka konsideruar se ai (dëshmitari) është përgjegjës. Këto raste ka paraqitur zyrtarëve parkut nacional "Sharri", gojarisht edhe me shkrim, prezent kanë qenë drejtori H. D., nuk i kujtohet mbiemri i personit me emër N., pylltarët Gj. I., S. V., I. N., S. M., H. K. Prej kur është punësuar në atë vend pune dikujt i ka penguar në veçanti L. sepse i njëjti në atë vend pune ka dashur ta punësonte djalin e vetë. Po ashtu ka pasur kërcënime nga E. K. dhe R. D. sepse nuk ka lejuar që të bëjnë prerje ilegale të druve në Parkun Nacional "Sharri", R. D. është zënë në flagrancë me datën 18.11.2011 duke vjedhur 14 lisa të llojit bung dhe ka qenë i dënuar me 3500 € për këtë prerje, ndërsa E. K., në kohën kur nuk ka punuar, ka shkretuar pyllin me prerje, të cilin rast ka paraqitur në Stacionin policor në Sreckës. Me datën 18 – 19 shkurt 2014 është formuar një komision prej gjashtë anëtarësh të cilit kanë bërë një kontrollim në teren por nuk e di në çfarë mënyrë kanë vlerësuar prerjen e druve prej 170m³ në vlerë prej 53.000 €, këtë situatë e ka pa vetëm në fotografi meqenëse nuk ka guxuar të shkojë në atë vende. Me datën 18.02.2014 kur është formuar komisioni me ta nuk ka shkuar në teren meqenëse kanë qenë prezent E. K. dhe L. H. me të cilit nuk ka raportet të mira, ndërsa 2 – 3 ditë më herët me kolegët S. M., I. N. dhe Gj. S. kanë dalë në një pjesë të terrenit që të bëjnë kontrollimin. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se prej sa është i punësuar nuk ka vizituar ato vende sepse ka qenë i kërcënuar dhe për këtë teren në çdo mbledhje L. H. vet ka theksuar se ai është përgjegjës. Nuk ka pasur rast ta sheh sasinë e druve për të cilat pretendohet se janë prerë, nuk ka ditur asgjë lidhur me regjistrimin dhe incizimin e sasisë së druve deri në momentin kur është arrestuar. Prej datës 02.07.2013 në mbledhje, drejtori H. D. verbalisht e ka njoftuar se duhet të zëvendësojë kolegun R. M. i cili është pensionuar dhe prej ditës së nesërme duhet të fillonte punën në mbikëqyrjen e terrenit Lubinje e Poshtme dhe të Epërme, në atë mbledhje nuk ka qenë L. H. Me datën 13.02.2014 bashkë me kolegun S. M., I. N. dhe Gj. S. me veturën zyrtare kanë qenë për kontrollimin e terrenit në atë pjesë ku ka

mund të vizitojë në mënyrë të sigurt edhe atë “Guri i Bardhë”, “Vërteshka” dhe “Bozile” dhe kanë vërtetuar se nuk ka pasur dëm ndërsa për data 14,15,19 dhe 20.02.2014 askush nuk e ka thirrur për të shkuar në kontroll, ai ka qenë në territorin e Lubinjës së Epërme.

Gjatë shqyrtimit kryesor gjykata ka administruar provat të propozuara nga ana e prokurorisë dhe palës së mbrojtur, janë dëgjuar dëshmitarët R. D., E. K., R. K., H. D., Gj. S., I. N., S. M., Z. A., eksperti i gjeodezisë F. S., E. K., S. D., B. B., L. H. dhe janë lexuar provat materiale, raporti i ekspertit gjeodezisë të datës 09.12.2015, raporti lidhur me pasqyrën e prerjeve të paligjshme të druve e përpiluar nga ana e komisionit të parkut nacional të datës 14.02.2014, 15.02.2014, 19.02.2014 dhe 20.02.2014, fotodokumentacioni nga shkresat e lëndës e cila përputhet me përmbajtjen e CD, kontrata e marrëdhënie e punës me nr. 361 (2) të datës 03.08.2011 dhe nr. 361 (3) të datës 03.08.2014, dhe faturat 000185, 000186, 000018, 000017, 000016, 000019, 000179, 000177, 000025, 000021, 000024, 000023, 000184, 000182, 000176, 000181, 000178, 000180, 000022, 000020, 000062, 000007, 000002, 000004, 000003, 000006, 000001, 000005.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, në bazë të rezultateve të procedurës së provave ka vërtetuar se është jokontestuese se i akuzuari F. H., në bazë kontratës së punës ka qenë në marrëdhënie pune në Parkun Nacional “Malet e Sharrit” si kujdestar i pyjeve, në periudhën kontestuese.

Mirëpo, në rastin konkret të akuzuarit F. H. i vihet në barë se në periudhën kohore prej shtatorit të vitit 2013 deri më datën 20.02.2014, në cilësinë e personit zyrtar-kujdestar në parkun nacional “Sharri”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe për persona të tjerë mundëson përvetësimin e pasurisë e cila i është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij, në atë mënyrë që në lokacionin e parkut nacional tek fshati M. ka lejuar prerje të mëdha të druve në sasi prej 170m³ në vlerë prej 53.074 € dhe me këtë ka kryer veprën penale përvetësimin në detyrë nga neni 425 par. 3 të KP-së.

Duke patur parasysh se figura e një veprë penale përfshinë një grup të tipareve të detyrueshme që bëjnë koncepte të veçanta të veprave të caktuara penale dhe pa realizimin e të gjithë elementeve të figurës së një veprë penale nuk ka as realizim të elementit të përgjithshëm i cili parashihet me ligj, përkatësisht nuk ka vepër penale nëse ndonjë gjendje faktike nuk mund të përfshihet si një përshkrim ligjor i ndonjë veprë penale.

Sipas përkufizimit ligjor, përvetësimi në detyrë (shpërdorimi) paraqet përvetësim të parave, letrave me vlerë apo sendeve të tjera të luajtshme nga ana e personit të cilit i janë besuar ato në bazë të detyrës ose brenda një organit publik, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete apo për tjetrin. Veprimi i kryerjes së veprës penale është përcaktuar si përvetësimi i sendeve të theksuara, të cilat janë objekte të veprës penale të përvetësimit.

Pra, duke pasur parasysh se i akuzuari si kujdestar i pyllit ka pasur për detyrë të kujdeset për drutë e atij pylli, të cilat dru derisa janë të paprera dhe të lidhur me tokën cilësohen si send e paluajtshëm, e nga ana tjetër duke pasur parasysh përcaktimin e objektit e kësaj veprë penale, gjykata konsideron se në veprimet e të akuzuarit nuk formohen elementet e figurës së veprës penale të përvetësimit në detyrë nga neni 425 par. 3 të KP.

Pran gjendjes së këtillë të çështjes janë krijuar të gjithë kushtet nga neni 364 par. 1 nënpar. 1.1KPP për marrjen e aktgjykimit lirues.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 454 par. 1 të KPP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 par. par. 3 KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.150/14 të datës 07.04.2017

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Përkthyesja gjyqësore
Asnije Berisha

Kryetarja e trupit gjykues
Raima Elezi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.